



**Republika e Kosovës, Republika Kosova, Republic of Kosovo**  
Ministria e Shëndetësisë, Ministarstvo Zdravstva, Ministry of Health  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Univerziteteska Bolnička i  
Klinička Služba Kosova, Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo  
**Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital**  
**“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA” Prizren**  
Adresa: Sheh Emini, p.n. 20000, Prizren  
[www.spitali-prizren.com](http://www.spitali-prizren.com), E-mail: [spitali.prizren@rks-gov.net](mailto:spitali.prizren@rks-gov.net)  
Tel: +383 (0)29 243 134



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosovo Cumhuriyeti  
Ministria e Shëndetësisë  
Ministaro Zdravstva - Sağlık Bakanligi  
SHSKUK - DRUK - KUKUK  
SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE  
“Prim. Dr. Daut Mustafa”  
Njësia Org. I Nr.Prot. 15/18  
Org.Jedinica Br.Prot. 7/2023  
Org.Bëhimë Nr. Prot. No. 2023  
Nr. i faqeve 3 Datum: 23/06/2023  
Er. stranica  
Safa

Mbështetur në Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Spitalit të përgjithshëm duke u bazua në **Nenin 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 si dhe Nenit 13 pika 1.1. Statutit të Spitalit**. Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm Prizren “prim.dr.Daut Mustafa”, me numër **7/95**, të datës **20/06/2023**, Spitali i Përgjithshëm Prizren me datë **23/06/2023**, morri vendim të shpallë këtë:

### FTESË PËR OFERTIM NË ANKAND PUBLIK

#### TITULLI: “LËSHIMI ME QIRA I HAPËSIRAVE TË PARKINGUT TË SPITALIT” SHFRYTËZIM AFATËSHKURTËR

Të drejtë pjesëmarrje në këtë procedurë kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët janë të interesuar për ofertim.

#### *Kohëzgjatja e kontratës me qiramarrësin:*

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 7 (shtatë) vite.

#### *Pjesëmarrësve në konkurrim/ofertim iu garantohen këto të drejta:*

- Trajtim i barabartë,
- Informim lidhur me procedurën e ankandit publik,
- Ofrim i mundësisë së vizitës së pronës dhe hapësirave që jepen me qira,
- Tërheqja nga ankandi publik jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik pa penalizim.

#### *Kushtet dhe kriteret për lëshimin e hapësirave të parkingut të Spitalit me qira:*

- Hapësirat e parkingjeve, të cilat janë ofertuar për qiradhënie, gjenden në Spitalin e Përgjithshëm Prizren me një sipërfaqe totale prej 15000 metër katrorë (m<sup>2</sup>) (hapësira të jashtme 16000 m<sup>2</sup> dhe hapësira të gjelbëruara 65000 m<sup>2</sup>)
- Qiramarrësi do ta ketë të drejtën që në hapësirat e marra me qira të bëjë përmirësime dhe adaptime shtesë në infrastrukturë, investime të cilat do të mbulohen nga vet qiramarrësi;
- Qiramarrësi do të ketë në dispozicion të gjitha pajisjet e nevojshme të cilat ndodhen në hapësirat që jepen me qira;

- Qiramarrësi duhet të kompletojë dhe modernizoj infrastrukturën e re të hapësirave të parkingjeve sipas standardeve të larta si dhe të bëjë investime në digjitalizimin e shërbimeve që do të ju ofrohen qytetarëve;
- Qiradhënësi do të paguaj të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës, ujit dhe sigurimit.

#### ***Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim:***

- Operatorët ekonomik të cilët kërkojnë të marrin pjesë duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin (të dëshmohet me kopje);
  - Numrin fiskal të biznesit (nëse nuk ka numër unik) (të dëshmohet me kopje);
  - Çertifikatën e TVSH-së (të dëshmohet me kopje);
  - Personat fizik duhet të dorëzojnë kopjen e letërnjoftimit;
  - Operatori ekonomik duhet të mos ketë obligime tatimore në 90 ditët e fundit (të dëshmoj me Vërtetim të ATK-së);
  - Operatori ekonomik duhet të mos jetë i dënuar apo në procedurë të falementimit në 90 ditët e fundit (të dëshmoj me Certifikatë nga Gjykata Komerciale);
  - Të ketë përvojë në aktivitetet e menaxhimit të patundshmërisë në bazë të pagesës/kontratës apo menaxhimit të natyrës së ngjashme për së paku 7 vite (të ofrojnë dëshmi me referencë);
  - Të ketë së paku 7 punëtorë (lista e punëtorëve me dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës);
  - Të ketë të regjistruar veprimtarinë e aktivitetit të menaxhimit të patundshmërisë në bazë të pagesës ose kontratës (të ofrohet dëshmi);
  - Të ketë në tre vitet e fundit në total realizim financiar (xhiro) në fushën e ngjashme të menaxhimit të kësaj kontrate së paku 300,000.00€ (treqind mijë euro) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 (të ofrohen dëshmi me deklarata tatimore nga ATK);
  - Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se është i certifikuar sipas standardeve ISO për sistemin e menaxhimit të cilësisë (9001) dhe sistemin e menaxhimit të ambientit (14001) (të ofrojnë dëshmi kopjet e certifikatave);
  - Operatori ekonomik duhet të prezantoj planin e investimit sipas pikave të mëposhtme të pasqyruar në plan të biznesit (të dëshmohet me dokument);
  - Operatori ekonomik mund të aplikoj individualisht apo si grup i operatorëve ekonomik, lideri në rast të grupit duhet të plotësojë minimumin e kriterëve dhe dokumenteve të kërkuara si më lartë (të plotësohen anekset origjinal).

#### ***Kohëzgjatja e ofertës për shprehje të interesit dhe mënyra e aplikimit:***

Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në zyrën e Prokurimit në Spitalin e Përgjithshëm Prizren nga data **23/06/2023**, deri më date **14/07/2023**

1. Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur (fizike).
2. Ofertat duhet të dorëzohen në Administratën e Spital-it, zyra numër 4.
3. Ofertat e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, nuk do të merren në shqyrtim.
4. Kohëzgjatja për shpalljen e ofertës është e hapur 20 (Njëzetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të kësaj oferte, **përkatësisht nga data 23/06/2023 deri më 14/07/2023.**

5. Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë që paraprakisht t'i vizitojnë hapësirat e lartëcekura në Spitalin e Përgjithshëm Prizren dhe t'i verifikojnë sipërfaqet e hapësirave.
6. Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj Spitalit të Përgjithshëm Prizren.
7. Ofertat dorëzohen në një zarf, në të cilin shkruhet "Ofertë për lëshimin e hapësirave të parkingut të Spitalit me qira", brenda të cilit duhet të jenë dy zarfe të tjera. Në njërin zarf vendoset i tërë dokumentacioni dhe materiali i kërkuar, ndërsa në zarfin tjetër vendoset vetëm pjesa financiare - çmimi i ofruar mujor për shfrytëzimin e hapësirave me qera sipas kërkesave të mëposhtme. Ofertat duhet të jenë të nënshkruar dhe e vulosur.
8. Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura me datë **14/07/2023 nga ora 10:00 deri në ora 12:00**

***Vendi, koha e mbajtjes së ankandit publik:***

Ftohen të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët dorëzojnë ofertat e tyre që me datë **14/07/2023** në **ora 13:00** të jenë prezent në hapjen e ofertave të mbyllura të cilat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtëpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

**Hapja e ofertave do të bëhet me dt.14/07/2023 në ora 13:00 në sallën e Entit higjienik**

***Vërejtje:***

Tërheqja e aplikacioneve për ofertim në këtë ankand publik ashtu siq e kemi cekur mund të tërhiqen në Rruga Sheh Emini p.n. - zyra e prokurimit pranë Spitalit të Përgjithshëm në Prizren.

Data:23/06/2023, Prizren

